



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA KORÇË**  
**NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_ Prot

Korçë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Materiale hidraulike”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

- **Materiale hidraulike 44115210-4**

**VLERA E FONDIT LIMIT QË PROKUROHET: 1,245,367 (një milion e dyqind e dyzet e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë.) lekë PA TVSH.**

**Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit duke marre 3 (tre) oferta nga operatorët ekonomike që operojnë në treg dhe duke përlogaritur vlerën mesatare të tyre në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 76, paragrafi i parë pika b), të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vleres të parashikuar të kontrates.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

*Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogel se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

---

### **2.2 Kapaciteti teknik:**

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

---

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

---

## II.ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Termat e referencës, sasi të, specifikimet teknike janë hartuar nga personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike caktuar me **urdherin Nr.70 dt.01.04.2026**.

**Ato janë si më poshtë:**

Nr	Emërtimi	Njesia	Sasia
1	Sprucatore PGJO4 φ 1/2	cope	350
2	Sprucatore PSU-04 -15A	cope	300
3	Sprucatore SRM04 φ 1/2	cope	100
4	Saraqineske bronxi φ 3/4	cope	50
5	Saraqineske bronxi φ 1”	cope	50
6	Ta plastike φ 32 x 3/4 x 32 M	cope	40
7	Brylla plastike φ 32 x 3/4 M	cope	40
8	Bashkues plastike φ 32 x 3/4 M	cope	40
9	Kondra valvula suste φ 2”	cope	10

10	Saraqineske bronxi $\phi$ 2"	cope	40
11	Saraqineske bronxi $\phi$ 1 1/2	cope	40
12	Bojler vertical 80 L 4 KW	cope	2
13	Bojler 10 L	cope	2
14	Hollandeze xingato $\phi$ 2"	cope	15
15	Hollandeze xingato $\phi$ 1 1/2	cope	15
16	Lavaman + Kollone porcelani	cope	2
17	Rubineta tek lavamani	cope	10
18	Rubineta Kendore $\phi$ 1/2 x 1/2	cope	20
19	Linaca	kg	1
20	Enezgjerimi 100 L	cope	6
21	Prestostat PM5	cope	6
22	Prestostat PM12	cope	6
23	5 degeshe bronxi pompe $\phi$ 1"	cope	8
24	Grup lavamani	cope	5
25	WC + kasete porcelani	cope	3
26	WC Allaturka	cope	10
27	Kasete plastike WC	cope	10
28	Pisuare WC	cope	8
29	Buton pisueri	cope	8
30	Sifon zorre $\phi$ 32	cope	20
31	Bashkues fileto $\phi$ 50 x 2" M	cope	60
32	Bashkues fileto $\phi$ 50 x 2" F	cope	20

**Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

**Kontraktuesi duhet të furnizojë mallrat në përputhje me standardet e kërkuara dhe specifikimet teknike, me shpenzimet e tij, deri në dorëzimin në vendin e përcaktuar, që është magazina e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë.**

**Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës bëhen pjesë e dokumenteve të tenderit.**

*Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

**GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Afati i ekzekutimit është **20 (njëzet) ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës.

**NJËSIA E PROKURIMIT**